

Fleta e punës për nxënësit 5.1

Përgatitjet për konferencën për një kuadër rregullash

Orari

Afati kohor	Agjenda	Materialet dhe burimet
Mësimi 1	Formimi i grupeve të punës. Secili grup përfshin një anëtar nga çdo fshat peshkimi.	Fletët e punës 5.1, 5.2.
Mësimi 1 Mësimi 2	Grupet hartojnë një kuadër të rregullave. Grupet përgatisin prezantimet e tyre. Anëtarët e komunitetit miratojnë rregullat e procedurës dhe votimit për konferencën.	Fletët e punës 5.2, 5.4. Tabelë dhe lapustila.
Mësimi 3	<i>Takim Plenar:</i> Grupet paraqesin projektet e tyre. Anëtarët e komunitetit krahasojnë dhe gjykojnë draft kuadrin e rregullave. Anëtarët e komunitetit diskutojnë për kuadrin që duhet të miratojnë.	Fletët e punës 5.3
Mësimi 4 Konferenca	<i>Konferenca:</i> Anëtarët e komunitetit mbajnë fjalim të shkurtër promovues për modelin e zgjedhur prej tyre. Ata miratojnë një kuadër rregullash me shumicë votash. Ata nënshkruajnë dokumentin kornizë origjinal. <i>Reflektim</i> Nxënësit reflektojnë për përvojat e tyre.	Fletët e punës 5.4 Fletë A4 e bardhë, stilolapsa, lapustila.

Pse duhet të luani lojën e vendimmarrjes?

Metoda e zbatuar në orarin e mësipërm është një lojë vendimmarrjeje. Arsyeja për zgjedhjen e kësaj metode është në vijim.

Loja punon si një model. Ajo paraqet aspekte të rëndësishme të realitetit. Ajo i tregon ato qartë, por duke lënë jashtë shumë detaje të tjera. Të gjitha vendet kanë një lloj kornize bazë, një kushtetutë që paraqet rregullat për marrjen e vendimeve dhe zgjidhjen e konflikteve. Pa një kuadër të tillë, anëtarët e një komuniteti nuk do të kenë mbështetje për zgjidhjen e konflikteve të tyre dhe për rrjedhojë mund t'i drejtohen dhunës.

Kur merrni pjesë në demokraci, ju ushtroni të drejtat që jua ka dhënë kushtetuta e vendit tuaj. Mënyra më e mirë për të kuptuar si vepron kuadri i rregullave dhe ligjeve në vendin tuaj, është të krijosh vetë një kuadër të tillë. Kjo lojë vendimmarrjeje ju vendos në këtë situatë.